VENDIM
Nr.864, datë 12.6.2009

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR "TV KOMBI"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë" si dhe Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit "Kombi" sh.p.k., për televizionin kabllor privat "TV Kombi", sipas licencës nr.006/RTV Kabllor, në qytetin e Patosit.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici